



## Rekordet Shëndetësore të Nxënësit Online

Familje të Nxënësve të Shkollave Publike Worcester,

Shkollat Publike Worcester janë të lumtura të njoftojnë se Departamenti i Infermierisë ka filluar një PORTAL të ri SHENDETESOR. Portali Shëndetësor do t'ju lejojë të paraqisni/dorëzoni informacion shëndetësor dhe të shikoni të dhënat shëndetësore të fëmijës tuaj në internet. Për të krijuar llogarinë tuaj, ju lutemi shkruani informacionin e kontaktit të kujdestarit kryesor të fëmijës tuaj duke klikuar në Skedën e Regjistrimit të Portalit Shëndetësor (Health Portal Enrollment) në faqen e internetit të Shkollave Publike Worcester, [worcesterschools.org](http://worcesterschools.org). Kjo do të inicijojë hyrjen tuaj në këtë faqe të sigurt të mbrojtur me fjalëkalim. Ju do t'ju duhet ID-ja e nxënësit e fëmijës tënd për t'u identifikuar dhe për të hyrë në llogari.

**Regjistrimi në Portalin Shëndetësor:** <https://worcesterschools.org/health-portal-enrollment/>

Portali Shëndetësor do ta bëjë më të lehtë për ju që të paraqisni/dorëzoni informacion shëndetësor në mënyrë virtuale dhe të shikoni rekordet shëndetësore të nxënësit tuaj në çdo kohë.

**Portali Shëndetësor SNAP do t'ju japë mundësinë të:**

- Shikoni online rekordet e vaksinimit dhe të shëndetit të nxënësit tuaj
- Ngarkoni dokumente mjekësore direkt në regjistrin shëndetësor të fëmijës tuaj (përfshirë shënime nga doktori, porositë e ilaçeve, ekzaminimet fizike, rekordet e vaksinave, etj.)
- Komunikoni direkt me infermjeren e shkollës tuaj
- Merrni përkujtesa, përditësime, dhe njoftime
- Merrni letra referuese direkt nga infermjerja
- Zgjidhni se cilat ilaçe pa recetë (over-the-counter) ju miratoni/ lejoni që fëmija juaj të marrë në shkollë

### **E RENDESISHME- JU LUTEM LEXONI!!**

Para se të merrni ftesën tuaj për të hyrë në portal, është thelbësore që ju të **klikoni në linkun mëposhtë për të caktuar se kush do të ketë akses të informacionit shëndetësor konfidencial të fëmijës tuaj.**

**HAPI 1.** Futni informacionin në këtë LINK: <https://worcesterschools.org/health-portal-enrollment/>

**HAPI 2.** Pasi të keni plotësuar Hapin 1, një ftesë nga Portali Shëndetësor SNAP do t'ju dërgohet me email nga [noreply@studentehr.com](mailto:noreply@studentehr.com)

***Kjo është një faqe interneti e sigurtë e mbrojtur me fjalëkalim që mund të aksesohet 24 orë në ditë.***

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem kontaktoni infermjeren(in) e fëmijës tuaj. Ai/ajo do ti përgjigjet me kënaqësi çdo pyetjeje që mund të keni.

Në shëndet të mirë,

Dr. Debra McGovern

Drejtoreshë e Infermierisë dhe Shërbimeve Shëndetësore në Shkollë

Shkollat Publike Worcester

01/21/2021